

NJOFTIM PËR KONSULTIMIN PUBLIK

PROJEKTLIGJI “PËR PRODUKTET MJEKESORE VETERINARE”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, fton qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për Produktet Mjekesore Veterinare”.

Qëllimi i këtij projektligji është krijimi i një kuadri ligjor të plotë dhe të harmonizuar për rregullimin e produkteve mjekësore veterinare, duke përcaktuar rregullat për futjen e tyre në treg, prodhimin, importin, eksportin, furnizimin, shpërndarjen, farmakovigjilencën, kontrollin dhe përdorimin e tyre.

Hartimi i këtij projektligji lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integritit evropian, veçanërisht me përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e produkteve mjekësore veterinare, sigurisë ushqimore, mbrojtjes së shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve.

Efektet e pritshme:

Efektet kryesore që priten nga miratimi dhe zbatimi i projektligjit janë:

- përmirësimi i standardeve për autorizimin e tregtimit, prodhimin, importin, eksportin, furnizimin, shpërndarjen, kontrollin dhe përdorimin e produkteve mjekësore veterinare;
- forcimi i sistemit të farmakovigjilencës dhe i mekanizmave për evidentimin, vlerësimin dhe parandalimin e efekteve të padëshiruara që lidhen me përdorimin e produkteve mjekësore veterinare;
- parandalimi dhe kufizimi i zhvillimit të rezistencës ndaj antimikrobikëve, nëpërmjet vendosjes së rregullave më të qarta për përshkrimin dhe përdorimin e tyre;
- përmirësimi i sistemeve të informacionit, regjistrimit, gjurmueshmërisë dhe raportimit për prodhimin, tregtimin, shpërndarjen dhe përdorimin e produkteve mjekësore veterinare;
- garantimi i një niveli më të lartë të sigurisë ushqimore për produktet me origjinë shtazore të përfituara nga kafshët e trajtuara me produkte mjekësore veterinare;

- forcimi i kontrollit mbi mbetjet e substancave farmakologjikisht aktive dhe parandalimi i përdorimit të paligjshëm të substancave me veprim hormonal ose tireostatik dhe të beta-agonistëve;
- krijimi i kushteve më të favorshme për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit blegtoral dhe të akuakulturës, rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve me origjinë shtazore dhe përmbushjen e standardeve të nevojshme për tregtimin e tyre në tregun e Bashkimit Evropian dhe në tregje të tjera ndërkombëtare.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë arsyet për mënyrën se si ato janë reflektuar ose jo në projektakt.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektaktit.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë (20 ditë pune), nga data 31 korrik 2026 deri më 28 gusht 2026.

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektaktin

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjin, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:

- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në adresën :Kjara.Vogli@bujqesia.gov.al.